



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**  
**Nr. 398, datë 07.10.2020**

**PËR**  
**PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË PRANË GJYKATËS**  
**ADMINISTRATIVE TË APELIT, PËR POZICIONIN E LIRË TË SHPALLUR ME**  
**VENDIMIN NR.188, DATË 28.05.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 3, të nenit 90 dhe nenin 95, të Kodit të Procedurave Administrative, në pikën 2, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 61, në shkronjën “ç”, të nenit 86, në pikën 3, të nenit 97 dhe në nenin 100, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, pasi konstatoi se zënien në mënyrë të përhershme të pozicionit të lirë për të cilin, me Vendimin e tij nr.188, datë 28.05.2020, është hapur procedura e ngritjes në detyrë pranë Gjykatës Administrative të Apelit, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

**V E N D O S I :**

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë pranë Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 188, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Kandidimi i gjyqtarit {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 188 datë 28.05.2020, konsiderohet si kandidim në procedurën e ngritjes në detyrë pranë Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 187 datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
3. Ky vendim u njoftohet gjyqtarëve që kanë kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.188, datë 28.05.2020, znj. {...}, z. {...}, z. {...} dhe z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**